

Fati Iseni, PhD<sup>1</sup>  
Agim Jakupi, PhD<sup>2</sup>

**REVOLUCIONI XHONTURK (TURQVE TË RINJ) TE PERANDORIA  
OSMANE NË VITIN 1908 DHE SHQIPTARËT**

**МЛАДОТУРСКАТА РЕВОЛУЦИЈА ВО ОТОМАНСКАТА  
ИМПЕРИЈА ВО 1908 ГОДИНА И АЛБАНЦИТЕ**

**THE YOUNG TURK REVOLUTION IN THE OTTOMAN EMPIRE IN  
1908 AND THE ALBANIANS**

**Abstract**

The suspension of the Ottoman Constitution of 1876, the severe financial crisis, the weakening of the army, the continuous loss of wars and territories, the rise of intellectual and political awareness within the empire—including among Albanians—the hopes of peoples to gain freedom or some form of autonomy within the empire, possibly also the identification of the Bektashis (Malcolm: Kosovo: 1998, p. 237) with the Young Turk cause, the Third Army Corps stationed in Macedonia where Albanians were well represented, as well as many other factors, led to the outbreak of a revolution. In this process, Albanians also participated in restoring the constitutional monarchy of 1876.

Although the financial, military, and political crisis had been evident since the Crimean War (1854–56), followed again by the Russo Turkish War of 1877–78, and Russian support for Slavic peoples seeking liberation from the Sublime Porte, during Russia’s march southward the Albanians positioned themselves on the Ottoman side. The geopolitical reasoning lay in easier defense against neighboring attacks. Although the Ottoman Empire was in collapse, Albanians

---

<sup>1</sup> Political Studies, Mother Teresa University, Skopje, North Macedonia; Email: fati.iseni@unt.edu.mk, <https://orcid.org/0000-0001-6160-5298>

<sup>2</sup> Mother Teresa University, Skopje, Republic of North Macedonia. Email: agim.jakupi@unt.edu.mk, <https://orcid.org/0000-0005-1930-0788>

remained deeply integrated into the imperial system and actively participated in all developments and transformations accompanying it.

**Keywords:** *Young Turks, Albanians, constitution, revolution, etc.*

## 1. Hyrje

Turqit e Rinj ose xhonturqit, dolën në sipërfaqe si një strukturë e mirëarsimuar dhe me një evolim kulturor shumë më të avancuar sesa pjesa tjetër e shoqërisë të ngjatur në mentalitetin e vjetër osman dhe me njëmendësi shumë burokratike dhe mesjetare në shumë qarqe.

Përfaqësuesit e kësaj lëvizje kombëtare borgjeze dhe progresive turke bënë pjesë në partinë “Bashkim e Përparim” (*Ittihad ve Terakki*). Komiteti i parë xhonturk në fillim u formua në Stamboll në mënyrë të fshehtë nga studentët e shkollës ushtarake mjekësore, në mesin e të cilëve ishte edhe shqiptari Ibrahim Temo. Mirëpo pas ndërhyrjes së qeverisë, qendra kryesore e lëvizjes u bart në Paris. Megjithëse xhonturqit ishin përkrahës të një monarkie kushtetuese dhe mbrojnë tërësinë e Perandorisë Osmane, ata kundërshtojnë autonominë e popujve të shtypur.

Më 3 korrik 1903, Nijazi Bej Resnja, me mbi 160 ushtarë do të shpallë kryengritjen dhe do t’i dërgojë telegram Sulltan Abdylhamidit të Dytë duke kërkuar që ta rikthente rendin kushtetues të vitit 1876.<sup>3</sup> Sipas raporteve të Konsullit të Austro-Hungarisë në Manastir, ishin mbi 200 ushtarë që kishin shpërthyer në revoltë.<sup>4</sup>

Sipas studiuesit Ferdinand Schevill: “Xhonturqit ishin një grup reformatorësh të cilët mendonin se perandoria mund të shpëtohej vetëm nga një proces evropianizimi.”<sup>5</sup>

Ndërsa studiuesi Ryan Gingeras, konsideron se: “Zhvillimi i hershëm i KOMITETIT PËR BASHKIM DHE PËRPARIM, pasqyroi pjekurinë intelektuale të Ahmet Rızës dhe të tjerëve përreth tij. Si një lëvizje e përbërë nga disidentë të vendosur kryesisht në Paris dhe Gjenevë, xhonturqit ishin njerëz të qetë me kulturën dhe idetë frankofone.

<sup>3</sup> Abdulhamid Kirmizi, Ferid Pashë Vlora, *Një Jetë Shtet*, Logos, 2018, F.35.

<sup>4</sup> Telegram inga Posfai, konsull austro-hungarez në Manastir, dërguar për Baron Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, me, 5 korrik 1908, numër 014, Telegrami i koduar nr. 214, Manastir, 5 korrik 1908, Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 129.

<sup>5</sup> Ferdinand Schevill, *Ballkani Historia dhe Qytetërimi*, Uegen, Tiranë, 2002, f.367.

Veprat filozofike nga Auguste Comte dhe Gustave Le Bon ndikuan shumë në këndvështrimin e Rizës për politikën dhe shoqërinë.”<sup>6</sup>

Vlerësimi i dominimit të lëvizjes me aparencë më liberale në Stamboll erdhi dhe vijoi me mbështetjen fillestare të atyre progresistëve që përqafuan interesin për kulturat dhe historitë e krahinave ose rajoneve të tyre nga vinin ata. Kryesisht eksponentët aspirantë që kishin përqafuar thirrjen e komitetit për “Vëllazërim dhe Unitet”, gjithashtu synonin për reforma dhe autonomi më të madhe për armenët në Anadoll, arabët në Levant dhe shqiptarët në Ballkanin Perëndimor. Për t’i joshur grupet etnike dhe me qëllim shfrytëzimin e tyre, xhonturqit, në fillim, nuk refuzuan kategorikisht të gjitha ambiciet etnike dhe krahinore të identitetit apo të zhvillimit politik.

Ndërsa vet Sulltan Abdylhamidi i II-të, kishte shkruar se: “ Ata duan të përmbysin sistemin aktual duke gjetur pretekste hipokrite, si për shembull ndriçimin dhe përparimin e kombit, dhe duan gjoja të sjellin risi duke shkatërruar të gjitha ato gjëra që gjyshërit e tyre i kanë ndërtuar shekuj me radhë.”<sup>7</sup>

Disa nga atdhetarët shqiptarë si I. Temoja, Qemali, D. Hima, H. Ohri etj., duke shpresuar se me përmbysjen e regjimit të Abdylhamidit do të krijoheshin kushte më të mira për të siguruar autonominë e Shqipërisë, morën pjesë, qysh në fillim, në lëvizjen xhonturke, ku luftuan kundër prirjeve shoviniste të komitetit «Bashkim e Përparim». Por shumica e qarqeve patriotike shqiptare mbajtën ende në periudhën e parë të lëvizjes xhonturke, një qëndrim opozitar ndaj partisë “Bashkim e Përparim”. Megjithëse, dokumentet arkivore të Austro-Hungarisë, Britanisë së Madhe dhe shumë studiuesve me renome, flasin qartë për pjesëmarrjen e madhe shqiptare në këto trazira.

## 2. Shpërthimi i kryengritjes xhonturke

Posfai, konsull austro-hungarez në Manastir në telegramin dërguar për Baron Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 5 korrik 1908, me numër 014, telegrami i koduar nr. 214, Manastir,<sup>8</sup> thotë: “Nënkoloneli Niazi në Resnjë pardje pasi hoqi

<sup>6</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27.

<sup>7</sup> Kujtimet e mia nga politika, Sulltan Abdylhamit, Sira, Prishtinë, 2021, f. 82.

<sup>8</sup> Telegrami nga Posfai, konsull austro-hungarez në Manastir, dërguar për Baron Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, me, 5 korrik 1908, numër 014, Telegrami i

garnizonin me lajme të rreme për paraqitjen e një kompanie, nga magazina përvetësoi 75 pushkë dhe 15 kuti municionesh, si dhe arkën e batalionit me 600 lira, pas së cilës ai me disa ushtarë dhe nëpunës civilë, si dhe rreth 150 banorë myslimanë, ikën në male. Ngjashëm vepruan dy nëntogerët në Nakolec (Prespë), duke iu bashkuar të parit me disa ushtarë dhe rreshterin e xhandarmërisë dhe 70 pushkë. Numri i përgjithshëm i të ikurve është mbi 200. Sot këtu janë nisur 2 batalione për në Resnjë. Këto ngjarje përfaqësojnë hapat e parë domethënës të lëvizjes xhonturke, zgjerimi i mëtejshëm i së cilës pritet në të gjithë krahinën.”<sup>9</sup> Ndërsa të nesërmen, më 6 korrik 1908, Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, se Shemsi Pasha do të arrijë sot në Selanik me rreth 600 ushtarë, për të vazhduar nesër për në Manastir që t’i shuajë trazirat ushtarake në Kostur të nënmajorit Nijazi Bej.<sup>10</sup> Sipas raportit, Nijazi Bej kishte ikur në male me mbi 200 ushtarë dhe se nga popullata myslimane kishte formuar një njësit me rreth 800 vetë. Me të arritur Shemsi Pasha ishte qëlluar me armë nga njerëz të uniformuar dhe ishte vvarë.

Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 8 korrik 1908, se: “Informatori im i përmendur beson se edhe misioni i Munir Osman Pashës do të dështojë, sepse në rrethet e oficerëve lokalë nuk ka besim të plotë në besueshmërinë e trupave të vendosura në dispozicion të mushirit të përmendur, për kryerjen e detyrës së tij. Gjithashtu, duke qenë se çeta nën drejtimin e nënmajor Niaz Beut, për shkak të pasigurisë, u zhvendos nga Manastiri në Janinë, i dezertuar pas mbërritjes në Resnjë, ka mundësi që edhe trupat e caktuara për të përndjekur kryengritësit të refuzojnë të binden. Situata e të tre krahinave konsiderohet shumë e rëndë. Nuk mjafton që pushteti nuk ka mundur t’i kundërshtojë lëvizjet e trefishta (bullgare, serbe, greke) çetnike, si dhe zierjen e shqiptarëve në rajonin e Prizrenit, por

---

koduar nr. 214, Manastir, 5 korrik 1908, Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 129.

<sup>9</sup> По ату.

<sup>10</sup> Telegram nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, dërguar Baronit Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 6 korrik 1908, Telegrami i shifruar nr. 9721, Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 129.

tani ushtria, durimi i së cilës është gabuar prej vitesh, ka filluar të heqë dorë dhe që ishte mjete i vetëm për shkatërrimin e kompanive.”<sup>11</sup>

Raporti mbyllet duke konstatuar se, vëzhguesit/vlerësuesit individualë, të cilët e shohin rrugën e daljes nga kriza aktuale vetëm në pushtimin ndërkombëtar të vendit. Natyrisht që kjo e hapte rrugën e copëtimit të trojeve të Ballkanit nga Fuqitë e Mëdha dhe eventualisht një konflikt me përmasa më të zgjeruara pas involvimit të tyre.

### 3. Jehona e lëvizjes dhe zhvillimet në hapësirat shqiptare

Orientimi i xhonturqve në Kongresin e Parisit të vitit 1907 drejt kryengritjes së armatosur dhe premtimet që u bënë popujve të shtypur për t’u dhënë lirinë, barazinë dhe drejtësinë, u siguruan atyre përkrahjen e qarqeve politike të kombeve të ndryshme të Perandorisë. Rëndësi të madhe në fitoren e revolucionit xhonturk, që filloi me kryengritjen e reparteve ushtarake të Resnjës më 3 korrik 1908, pati bashkimi me të i komiteteve “Për lirinë e Shqipërisë”, i çetave të armatosura, i reparteve ushtarake të përbëra nga shqiptarë dhe i mijëra kosovarëve të mbledhur në Ferizaj. Për pakënaqësinë e shqiptarëve ndaj sulltanit dhe mbështetjen ndaj lëvizjes së Turqve të Rinj, raporton edhe Konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup, Rapaport, i cili e njofton ministrin e punëve të jashtme të Austro-Hungarisë, se disa mijëra shqiptarët të pakënaqur janë tubuar në Ferizaj, te hekurudha kah Mitrovica dhe se kolonel Galibi shkoi atje që të negociojë.<sup>12</sup>

Gjithashtu për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Resnjë dhe Manastir flasin qartë dokumentet britanike, të cilët theksojnë se Çerçiz Topulli dhe Adem Bej, ishin pjesë e këtij mobilizimi ushtarak por raporti i konsullit britanik nga Stambolli gjithashtu e vendos në dyshim pjesëmarrjen e Topullit në këtë lëvizje.<sup>13</sup>

“Për shkak të propagandës serbe se gjoja A-H synon ta okupojë Kosovën për shkak se kishin ndodhur të disa trajnimeve të nxënësve të

<sup>11</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 8 korrik 1908, Dokumenti nr. 119. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 136.

<sup>12</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Shkup, Rapaport, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 9 korrik 1908, Dokumenti nr. 119. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 139.

<sup>13</sup> TBA (The British Archives), CAB 37/95 – 1908, No 118, [27643] No. 4. Sir G. Lowther to Sir Edward Grey.- (Received August 10.), (No. 447.) Therapia, August 4, 1908.

shkollës së hekurudhave në Shkup, të cilat u interpretuan gabimisht para masës, menjëherë u mobilizuan shqiptarët në Ferizaj dhe deri më 5 korrik 1908, numri arriti rreth 3000, ndërsa autoritet osmane e kishin dërguar shefin e xhandarmerisë nga Shkupi që t'i qetësojë dhe shpërndajë, pa e ditur se i njëjti ishte e pjesë e kësaj lëvizje dhe me ndihmën e Nexhib Dragës dhe Bajram Currit deri kah mesi i korrikut ky numër arriti rreth 30.000.” (Malcom: Kosova: 237). Kështu, më 15 korrik 1908, mijëra shqiptarë nga Ferizaj i dërguan letër Sulltanit.<sup>14</sup>

Meqë gjendja ishte alarmante në Ferizaj, Mytesarifli Ismail Pasha nga Prishtina më 9 korrik 1908, kishte arritur në Shkup me ftesë të Guvernatorit Gjeneral në Shkup, i cili sipas konsullit austro-hungarez në Shkup, kishte qëllim që të qetësojë shqiptarët e tubuar në Ferizaj.<sup>15</sup>

Për jehonën e ndikimit të Komitetit të Xhonturqve në hapësirat shqiptare flet edhe një raport tjetër që konsulli i Austro-Hungarisë në Manastir, Posfai, dërguar ministrit të punëve të jashtme të Austro-Hungarisë, më 14 korrik 1908, njofton se në Resnjë, Ohër, Dibër, dhe Kërçovë si edhe në fshatrat përreth, edhe ushtria, administratorët dhe gati të gjithë banorët janë të përfituara nga lëvizja e Turqve të Rinj.<sup>16</sup> Raporti gjithashtu njofton se batalioni i gjuetarëve që ishte zhvendosur nga Manastiri për në Janinë, i cili në Resnjë refuzoi ta vazhdojë udhëtimin, tani ka nisur për në Janinë me qëllim që t'i ndihmojë lëvizjes xhonturke.<sup>17</sup>

Shtrirja e lëvizjes në hapësirat shqiptare vazhdon edhe nëpër viset e tjera. Sipas një raporti të zëvendës konsullit të A-H në Shkup, Lukes, drejtuar ministrit të punëve të jashtme të A-H, më 14 qershor 1908, njofton për zhvillimet në Gostivar dhe Shqipërinë e Veriut. Raporti shkruan: “Është e vërtetë, për shembull, se i nderuari Veli Beu nga Gostivari, shtëpia e të cilit u kontrollua me urdhër perandorak, u arratis me disa shokë në mal, duke u nisur drejt Dibrës për t'u bashkuar me kryengritësit.

<sup>14</sup> The Memoirs of Ismail Kemal Bey, Edited by SOMMERVILLE STORY, With a Preface by WILLIAM MORTON FULLERTON, LONDON CONSTABLE AND COMPANY LTD, 1920, f. 316.

<sup>15</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Shkup, Rapaport, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 9 korrik 1908, Dokumenti nr. 119. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 140.

<sup>16</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Manastir, Posfan, Rapaport, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 14 korrik 1908, Dokumenti nr. 45. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 146.

<sup>17</sup> По аты. F. 146.

Ngjarjet në Shqipërinë e Veriut në disa vende interpretohen edhe si të drejtuara kundër të pakënaqurve (murtadit-jobesimtarëve), madje edhe të inskenuara nga qeveria për këtë qëllim. Në fakt, ka konfuzion të plotë në pozitat udhëheqëse në lidhje me takimin e shqiptarëve në Ferizaj, në të cilin nga kjo zonë zyrtare po marrin pjesë kryetarët e Gjilanit, Preshevës, Kaçanikut, Tetovës dhe rrethinave të Gostivarit. Duke thirrur Guvernatorin e Përgjithshëm nga Prishtina në Shkup (...) Guvernatori pa sukses u përpoq të qetësonte shpirtrat dhe sot është pothuajse e qartë se përfundimi i paraparë (dhënia) e besës ishte përgatitur për një kohë të gjatë, duke pasur synime krejtësisht të ndryshme...<sup>18</sup>

#### 4. Kërkesa për ndërmjetësim e Nijazi Beut me Sulltanin

Me një telegram të gjatë Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 18 korrik 1908, se udhëheqësi i kryengritësve, nënmajor Nijaziu i dërgoi nga Starova, sanxhaku i Goricës (nga 186 shtëpi, 86 janë shqiptaro-ortodokse, 100 banorë shqiptaro-muslimane). Kryeinspektorit, përmbledhja e të cilit thotë: “Për shkak se propozimet nga njerëzit mi, dërguar Sulltanit dhe Kryeministrit, nuk kam marrë përgjigje deri më tani, po i drejtohem Shkëlqesisë Juaj me një kërkesë për të ndërmjetësuar mes Madhërisë së Tij, Portës dhe meje, dhe për hir të shpjegimeve të mëposhtme. Kalova një pjesë të Shqipërisë së sipërme, pastaj rrethin e Ohrit dhe të Kosturit dhe në biseda me banorët, pa dallim feje e kombësie, fitova bindjen se populli shtypet nga pushteti, se ligjet ekzistuese zbatohen në mënyrë të padrejtë, kështu që shpesh nuk sigurohet as jeta dhe as pasuria. Popullsia bashkohet me përpjekjen time për të rivendosur kushtetutën. i shoqëruar nga 250 trima bashkëmendimtar, të cilët si unë ia kushtojnë jetën një pune të mirë, sot nisem për në Epir, për të përhapur idenë time atje. Lus që konkluzioni i fundit i Sulltanit të më dorëzohet atje. Në rast se ai vazhdon të heshtë, ne dhe bashkëlufëtaret tanë xhonturq jemi gati të sakrifikojmë pikën e fundit të gjakut për fitoren e drejtësisë”.<sup>19</sup>

<sup>18</sup> Telegram i nga Zëvendës Konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup, Lukes, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 14 korrik 1908, Dokumenti nr. 118. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 156-157.

<sup>19</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Selanik, Bohumil Para, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 18 korrik 1908,

Në Telegramin nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Manastir, Posfai më 18 korrik 1908, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, se: “Propaganda serbe konsiderohet si *quantité négléible*). Propaganda vllahe ka kërkuar gjithmonë një anim të tepruar nga qeveria, në mënyrë që ajo të guxonte të shkonte më tej sesa thjesht simpati e heshtur. Megjithatë, arsyeja e kësaj simpatie është ndër të tjera edhe marrëdhënia e çmuar e besimit me shqiptarët.”

Shqiptarët, me sa dimë nga shumë pak informacione, po i bashkohen lëvizjes së re pa rezerva.

Thuhet se nuk do të vijë deri te besa e përgjithshme, por në shumë pjesë vërehen shenja qetësimi. (Kam dëgjuar diçka pozitive për dhënien e besës vetëm midis dy vendeve deri tani armiqësore shqiptare Dolencë dhe Kazhan që ndodhen midis Manastirit dhe Resnjës.)

Dyshohet se Debranët tashmë i janë bashkuar grupit të Nijaziut, i cili pak ditë më parë ka rrjedhur në drejtim të Starovës (bregu jugor i liqenit të Ohrit), ndërsa lidhje të tjera të tilla janë në pritje.

Vetë në Ohër, prej nga pres informacion më të detajuar së shpejti, veprimet e kryengritësve tashmë kanë marrë karakterin e një qeverie të përkohshme. Aty tashmë funksionon një komision ligjor. Rrethi rreth Manastirit po ngushtohet. Prilepi, përderisa bullgarët qëndrojnë në mënyrë pasive, nuk do të paraqesë asnjë pengesë për lëvizjen. Banorët shqiptarë nga fshatrat myslimanë të kazasë së Lerinit u shpërngulën pardje, në ditën e tregut të Lerinit, për t’u angazhuar për t’iu bashkuar lëvizjes së re.<sup>20</sup> Gjithashtu konsulli raporton se komandanti i jashtëzakonshëm në Manastir, mushiri Osman Pasha, deri tani nuk ka marrë asnjë aktivitet ndaj xhonturqve dhe se ka rrezik edhe atje të përhapet, si dhe ish komandanti i zonës së Manastirit Haxhi pasha, fshehurazi ka shkuar në Bullgari në negociata për t’i përfshirë bullgarët në lëvizje dhe së bashku me Shahin bej Kolonjën kanë shkuar në Vilajetin e Kosovës.<sup>21</sup>

Meqë zhvillimet politike dhe ushtarake ishin shumë të rëndësishme sikurse për Portën e Lartë ashtu edhe për Fuqitë e Mëdha, këto të fundit me shumë vëmendje e ndiqnin gjendjen nëpërmjet përfaqësive të

Dokumenti nr. 9757. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 159.

<sup>20</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Manastir, Posfai, Raport, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 18 korrik 1908, Nr. 46. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 161-163.

<sup>21</sup> Po aty.

tyre në terren dhe raportonin te qeveritë përkatëse. Kështu për ngjarjet në Ferizaj flet Telegrami nga zëvendës konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup, Lukes, i cili e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë, më 22 korrik 1908, se: “Pjesëmarrësit e mbledhjes së shqiptarëve në Ferizaj erdhën dje në Kaçanik dhe përzunë zyrtarin financiar, policinë dhe xhandarmërinë, të cilët po e ndihmonin në mbledhjen e taksave. Një përfaqësues i Guvernatorit të Përgjithshëm i bindi shqiptarët të ktheheshin; zyrtarët për momentin mbeten në Shkup. Paria e Shqipërisë e kanë telefonuar Valiun nga Ferizaji, se do të presin përgjigje nga Sulltani vetëm deri nesër, pa bërë të ditur synimet e mëtejshme.”<sup>22</sup>

Kështu, më 23 korrik 1908, konsullatat e Austro-Hungarisë në Manastir dhe Selanik, raportojnë se nënmajori Nijazi Beu kishte arritur nga Resnja në Manastir me 2000 apo 3000 forca, ndërsa aty u ishte bashkangjitur garnizoni dhe e kishin larguar Osman Pashën pa gjakderdhje, si dhe njoftohet se të njëjtën ditë pritej të shpallej Kushtetuta. Në qytet ishte ruajtur rendi dhe të gjithë shërbyesit zyrtar kishin ngelur në vendin e punës.<sup>23</sup>

## 5. Koordinimi i xhonturqve me shqiptarët

Pa dyshim që të gjitha zhvillimet e lëvizjes së xhonturqve që nga fillimi ishin të lidhura me personalitete të rëndësishme shqiptare, por edhe shtrirja dhe përmasat që morri ajo, sigurisht që ishin në hapësirat shqiptare më të theksuara se gjithkund. Me gjithë dilemat që ishin në mjediset shqiptare, si në ato intelektuale ashtu edhe në ato popullatës, sërish shihet qartë nga të gjitha dokumentet arkivore dhe studimet e bëra se shqiptarët ishin një nga faktorët kyç të lëvizjes. Kështu një nga udhëpërshkrueset e kësaj periudhe, Edith Durham do të shkruajë: “Sekreti i xhonturqve u ruajt mirë; por duket se disa turq të vjetër dyshonin se diçka po përgatitej. Njëri prej tyre, Shemsi Pasha, dërgoi lajmëtarë të hipur nëpër fiset myslimane, duke i thirrur ata menjëherë për të

<sup>22</sup> Telegrami nga zëvendës konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup, Lukes, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, Ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë, më 22 korrik 1908, Dokumenti nr. 7103. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f.167.

<sup>23</sup> Telegrami nga Konsulli Gjeneral i Austro-Hungarisë në Manastir, Posfan, Rapaport, e njofton Baronin Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 23 korrik 1908, Nr. 9929. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 168.

zmbropsur sulmin e një armiku të pritur. Nga shumë burra nga të cilët e kam dëgjuar përrallën e njëjtë këmbënguli që pararoja e ushtrisë austriake, në fakt kishin qenë dyzet batalione, gati ishin parë në kufi dhe se aneksimi austriak kishte qenë i pashmangshëm.

Pjesëtarët e fisit rrokën armët dhe nxituan - rreth nëntë mijë të fortë - në vendin e caktuar, Ferizaj, ku ata duhej të merrnin urdhra. Aty ata sulmuan një tren - raportohet se përmban armiq. Por Shemsi Pasha ishte "një ditë pas panairit". Xhonturqit e mposhtën atë. Ata qëlluan mbi të në Manastir; e morën me mjeshtëri avantazhin mbi situatën me faktit se pjesëtarët e fiseve ishin në Ferizaj; u bëri thirrje atyre të shpëtojnë vendin, dhe shpjegoi se diçka që quhet Kushtetutë ishte e vetmja mënyrë me të cilën mund të bëhej. Të ashpër, injorantë fisnorë, xhelozë vetëm për privilegjet e tyre dhe të drejtat territoriale dhe absolutisht të pavetëdijshëm se kjo ishte jo puna për të cilën ata ishin thirrur fillimisht, kërkuan me zë të lartë dhe njëzëri këtë amuletë të panjohur, "Kushtetuta", që do të mbante tokën e tyre të paprekur dhe shpëtojë Padishahun.

Sulltani dëgjoi se fiset myslimane - veçanërisht këta burrat, mbi gjithë të tjerët, ai që gjithmonë kishte llogarite - ishin me ushtrinë. Loja kishte përfunduar; ai u dorëzua menjëherë dhe Kushtetuta u dha. Kjo skicë kryesore e këtij narracioni, të cilën e gjeta gjerësisht të përhapur dhe të besuar, është e saktë, besoj se është përtej të gjithave dyshim i arsyeshëm. Fiset u mashtruan dhe shumë njerëz e kishin zbuluar tashmë këtë kur mbërrita unë Gjakovë."<sup>24</sup>

Në drejtim të lidhshmërisë së shqiptarëve me xhonturqit raporton edhe Alfred Rapaport, u.d. agjent civil i Austro-Hungarisë në Maqedoni, dërguar Baronit Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 24 korrik 1908, i cili konstaton: "Është e vështirë të nxirret një përfundim adekuat për gjerësinë e lëvizjes aktuale të përbashkët të shqiptarëve me xhonturqit, që është një simptomë shumë domethënëse e kësaj lëvizjeje. Sa i përket takimit në Ferizaj, është fare e qartë se motivet me të cilat shumica e pjesëmarrësve u motivuan t'i parashtrojnë kërkesë telegrafike Madhërisë së Tij për miratimin e Kushtetutës, ishin gjithashtu larg realitetit, pra reales. synimi i aksionit të xhonturqve, si dhe i atyre të lëvizjes kombëtare shqiptare, duke përdorur për këtë qëllim pothuajse të njëjtat parulla (ruajtja e privilegjeve të vjetra, ndalimi i reformave etj.), të cilat kanë qenë gjithmonë. ndikoi te shqiptarët kosovarë. Më interesante nga pikëpamja e çështjes shqiptare

<sup>24</sup> Edith Durham, High Albania, f. 299-300.

është lidhja e përbashkët e Çerçiz Topulit me xhonturkun Niaziun, të shpallur nga Manastiri, e justifikuar ndoshta me pozicionin e keq aktualisht të liderit çetnik shqiptar dhe që mund të ketë një rëndësi të gjerë.”<sup>25</sup>

Ndërsa konsulli austro-hungarez në Manastir, Posfai, më 31 korrik 1908, shkruan se lidhshmëritë e shqiptarëve dhe Turqve të Rinj, të cilën nënkoloneli Nijazi e kishte bërë vëllazërimin me Çerçiz Bej Topullin dhe Adem Eminin, kishte filluar para disa muajsh.<sup>26</sup> Më tej raporti për lidhshmërinë shqiptare me Komitetin vazhdon: “Raporti im më i nënshtruar i 5 qershorit të këtij viti, numri 36, fliste tashmë për afrimin që duhej të ishte dokumentuar kur një nga drejtuesit e propagandës kombëtare-shqiptare hyri në komitetin xhonturk. Siç kuptova tani, xhonturqve iu afruan në kohën e tyre patriotët shqiptarë Irfan beu nga Ohri (vëllai i të internuarit Hamdi beu dhe i afërm i Akif Pashës nga Elbasani) dhe Sulejman Efendi, në Selanik sekretari i Inspektorit të Përgjithshëm. Hilmi Pasha, Mid’hat Bej Frashëri dhe zëvendësi i prokurorit të shtetit Mina Vasil Orologa, si njerëz të besuar të propagandës shqiptare. Në këtë moment, partia shqiptare, me mbështetjen e plotë në Komitetin Xhonturk, është e zënë me organizimin më të fortë dhe hedhjen e themeleve për një aksion më të gjerë për ngritjen e ndjenjës kombëtare dhe aktivizimin e aspiratave të saj kombëtare.

Me lirinë e re, lulëzuan shpresat më të mira të atdhetarëve vendas shqiptarë. Por ata duket se nuk e marrin parasysh faktin që, për shkak të partikularizmit të fuqishëm të zhvilluar te shqiptarët, një bashkim i përgjithshëm nuk është ende i përgatitur sa duhet... Ndoshta nuk do të zgjidhet lehtë çështja e këshillimit për alfabetin, e cila është ngritur në plan të parë. Atdhetarë të rëndësishëm vendas mbanin çdo ditë takime të gjata me Çerçiz Topulin dhe Adem Eminin. Deri më tani është krijuar vetëm një shoqëri shqiptare dhe kryetar i saj është zgjedhur Riza Beu, inspektori sanitar vendas, si përfaqësues avokati i pasur Ferid Beu nga Kolonja, Rifat Beu, drejtor i regjisë, Gjergi Qyriazi, zyrtar nga këtu dhe Alexander Valtador, përkthyesi italian i pavarur. Detyrat më imediate

<sup>25</sup> Telegrami nga Alfred Rapaport, u.d. agjent civil i Austro-Hungarisë në Maqedoni, dërguar Baronit Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 24 korrik 1908, Nr. 77. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 177.

<sup>26</sup> Telegrami nga Posfai, konsulli i Austro-Hungarisë në Manastir, dërguar Baronit Alois von Ehrenthal, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, më 31 korrik 1908, Nr. 50. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907-1908, Том II, Скопје, 1981, f. 181.

janë përgatitjet për thirrjen e një kongresi të përgjithshëm shqiptar dhe ngritja e një gazete javore.<sup>27</sup>

Konsulli njofton duke dhënë detaje për angazhimin e shqiptarëve në të gjitha dimensionet. Ai vazhdon: “Direktivat për të gjithë organizatën vinin nga Mid’hat Bej Frashëri i Selanikut. Enver Beu dërgoi këtu dje njeriun e tij të besuar, Melet Beun e ri të Frashërit. Pas pak ditësh, ai duhet të shkojë në një udhëtim agjitacioni nëpër Shqipëri, në shoqërinë e 25 shokëve, ndërsa Çerçiz Topuli dhe Adem Eminin me 24 shokë, dhe me urdhër të komitetit vendas xhonturk, për të cilin i dhanë betim. Ai duhet të fillojë tashmë pasnesër në dy grupe me të njëjtin synim. Në përgjithësi ka një kërkesë të madhe për revistat dhe librat shqiptarë. Por tani për tani shpërndarja e materialeve ekzistuese të shtypura aktuale duhet të ndalet, për shkak të tonit të tyre shpesh jashtëzakonisht armiqësor.

Me lirimin e të gjithë të burgosurve në vilajet nga patriotët shqiptarë u lirua edhe predikuesi amerikan Tailke në Korçë, pastaj këtu edhe Qani Beu dhe Idrisi nga Gakova. Ky i fundit, për shkak të procedurave, në burg, me vdekje...”<sup>28</sup>

## 6. Refleksioni i politikës xhonturke te shqiptarët

Durham do të shkruan: “Pastaj erdhi revolucioni xhonturk në verën e vitit 1908. Ai premtoi liri dhe barazi për të gjithë. Shqiptarët luajtën një rol të madh në sukseset e saj të para. Burrat e Kosovës marshuan në Uskub (tani i quajtur Shkup, por më pas një qytet kryesisht shqiptar). Ata dëbuan qeveritarët e vjetër nga rrethi dhe pushtuan qytetin. Zëvendës konsulli ynë, mik i shqiptarëve, dëshmoi për sjelljen e mirë të trupave shqiptare.

Kushtetuta u shpall, Shkodra u egërsua nga gëzimi. Mijëra burra malësorë, në grupin më të mirë, marshuan në qytet, u gostitën dhe u festuan. Kemi qëlluar me revole (kisha një në secilën dorë) në ajër derisa nuk mbeti asnjë fishek. Nuk ka ndodhur asnjë aksident dhe asnjë çrregullim. Zëvendës konsulli francez tha: “Çfarë populli do të ishte ky me një qeveri të mirë!” Ata u kthyen në malet e tyre të lumtur dhe me shpresë. Duhet të kishte liri të shtypit. Gazetat shqiptare dolën si kërpudha natën. Shkollat u hapën me shpejtësi të madhe. Në Manastir u mbajt një Kongres për standardizimin e alfabetit dhe drejtshkrimin dhe

<sup>27</sup> Po aty, f. 182.

<sup>28</sup> Po aty, f. 182.

u miratua një alfabet universal. Shkollat e huaja kishin përdorur sisteme të veçanta. Rroftë Shqipëria! Ajo do të kishte mundësinë e saj më në fund. Nuk do të shoh më kurrë një ringjallje kaq të gëzueshme të një populli.”<sup>29</sup>

Ndërsa në një raport të ambasadorit britanik në Stamboll, Gerard Lowther dërguar sekretarit të jashtëm britanik Edward Grey, në mes tjerash shkruan: “Shqiptarët raportohet se janë të kënaqur që kanë fituar diçka, megjithëse nuk e kuptojnë plotësisht se çfarë është; ata në çdo rast kanë avantazhin e prekshëm se tani janë të lirë të shkarkojnë armët e tyre të zjarrit në rrugët e qytetit. Ata sigurisht që nuk i kuptojnë detyrimet që u ngarkohen nga një sundim i rendit dhe ligjit.”<sup>30</sup>

Studiuesi Gingeras do të konstatoj: “Debatet mbi të drejtat gjuhësore dhe arsimore përkeqësuan pikat e tjera të grindjes rajonale ose nacionaliste. Ndërsa qeveria përfundimisht lejoi një shkallë të arsimit lokal në gjuhët joturke, qeveria e pas-puçit të vitit 1909 u mohoi nacionalistëve të drejtën për të krijuar parti me përkatësi të qarta arabe, bullgare, shqiptare, kurde ose të tjera “kombëtare”. Tensionet u rritën në mënyrë graduale jashtë kryeqytetit ndërsa administrata e udhëhequr nga KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM vazhdoi me agjendën e saj centralizuese në fronte të tjera. Nga frika e rritjes së aktivitetit militant në Ballkan dhe Anadoll, Stambolli nisi një politikë të re të çarmatimit në mbarë perandorinë mes fshatarëve dhe banorëve të qytetit. Së bashku me këtë hap drejt dobësimit të potencialit të dhunshëm në mesin e komuniteteve rurale ishte një stres i përtërirë mbi rekrutimin masiv dhe taksimin e barabartë. Ndërsa regjimet e universalizuara të shërbimit ushtarak dhe mbledhjes së taksave kishin qenë shenja dalluese të qeverive osmane përpara vitit 1908, reagimi i shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor, si dhe i përfaqësuesve të tyre në asamblenë kombëtare, ishte i shpejtë dhe i ashpër. Në vend që të forconin një kontroll më të madh administrativ mbi malësitë shqiptare, fshatarët, me mbështetjen e elitës vendase, u ngritën në rebelim. Valët e kryengritjes antiqeveritare ndërmjet viteve 1910 dhe 1912 shkaktuan njëllë dezertimin masiv të përfaqësuesve shqiptarë të KOMITETIT PËR BASHKIM DHE PËRPARIM.”<sup>31</sup>

<sup>29</sup> [http://www.albanianhistory.net/1941\\_Durham/index.html](http://www.albanianhistory.net/1941_Durham/index.html) Edith Durham.

<sup>30</sup> TBA, CAB 37/95, 1908 No 118, [27643] No. 4. The British ambassador in Istanbul, Sir Gerard Lowther to Sir Edward Grey. - (Received August 10.), (No. 447.), Therapia, August 4, 1908.

<sup>31</sup> Ryan Gingeras, The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922, 2016, f. 27.

## 7. Mjegullat politike rreth pozicionimit të shqiptarëve - pro et contra

Nëse marrim për bazë rrethanat historike në kohën përkatëse, atëherë konceptimi i te gjitha zhvillimeve politike të kohës sigurisht që të shtyn të analizosh lëvizjen shqiptare edhe në koordinata tjera për të cilat historiografia jonë jo çdoherë ka qenë e përgatitur. Në këtë dimension politik, eksponentët kryesor politik dhe personalitetet me peshë në hapësirat shqiptare, kryesisht vlerësuan se një ndryshim rrënjësor i sistemit politik brenda perandorisë mund të reflektonte edhe në avancimin e statusit juridik dhe politik të shqiptarëve. Kështu një nga personalitetet e rëndësishme si Nexhib Draga dhe familja e tij ishin involvuar që nga vitet 1890-të, ndërsa komitetet të Turqve të Rinj kishin në Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Dibër.

Studiuesi Gingeras shkruan: “Kështu redaktori i Tanin<sup>32</sup>, për shembull, gjeti arsye për të mbështetur përpjekjet e intelektualëve shqiptarë që po zhvillonin një gjuhë shqipe të shkruar me shkrim latin (duke arsyetuar se reforma të tilla ndoshta mund të zbatoheshin në turqishten osmane.”<sup>33</sup>

“Kundërshtarët argumentuan se imponimi i turqishtes mbi komunitetet lokale nuk u shërbente rreptësisht nevojave administrative dhe politike të shtetit, por zbuloi një model të bashkërenduar të “turqizimit”. Ismail Qemali, i cili iku nga perandoria pas incidentit të 31 marsit, deklaroi se KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM kishte mashtruar shqiptarët dhe të tjerët me thirrje për unitet.”<sup>34</sup>

Për korrektësi, shumë dokumente të diplomacisë britanike të kohës, udhëpërshkrues relevant si Edit Durham, studiues me renome si Malcom, Ferdinand Schevill, Ryan Gingeras, *The Memoirs of Ismail Kemal Bey*, Jason Goodwin, TBA (The British Archives), dhe shumë të tjerë, na lënë të kuptojmë se në fillim ende nuk ishte e kristalizuar ideja e mbështetjes së revolucionit të Turqve të Rinj nga shqiptarët. Nga raportimet dhe analizat e tyre, here shihet që ishte lëvizje dhe

<sup>32</sup> Tanin (turqisht: “rezonancë”) ishte një gazetë turke. Ajo u themelua në vitin 1908 pas Revolucionit Xhonturk, nga Tevfik Fikret poeti osman, i cili konsiderohet themeluesi i shkollës moderne të poezisë turke. Ajo u bë një mbështetëse e fortë e partisë së re progresive në pushtet, Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit.

<sup>33</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912–1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908–1922*, 2016, f. 27.

<sup>34</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27.

grumbullim spontan, e here edhe e orkestruar nga disa krerë shqiptar të cilët nuk ishin në një vijë me Sulltan Abdulhamitin e II dhe si të tillë ishin të padëshiruar në Stamboll.

Ismail Qemali rreth këtyre zhvillimeve do të shkruante: “Munir Pasha, ambasador në Paris, ishte larguar në Kustendje me një mision qeveritar kur mësoi për revolucionin në Kostandinopojë. Ai u kthye menjëherë në Paris dhe më kumtoi një kërkesë për mua nga Qamil Pasha që të kthehesha në Turqi. Unë u përgjigja se nuk do të kthehesha derisa të anulohet dënimi ndaj meje dhe të më riktheheshin të gjitha të drejtat e mia civile. Duke shkuar menjëherë në Londër, mora një njoftim zyrtar nga Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet Ambasadorit, për anulimin e vendimit kundër meje dhe rikthimin dhe riintegrimin tim në të drejtat e mia. Rreth kësaj kohe Standardi botoi një telegram nga Italia ku thuhej se në Bari kishin mbërritur rreth dy deri në tre mijë shqiptarë për të më takuar dhe për të më shoqëruar deri në Vlorë. Të nesërmen mora një telegram, të nënshkruar nga një numër i madh shqiptarësh, në të cilin në emër të të gjithë bashkatdhetarëve të mi më ftonin të shkoja menjëherë në Vlorë dhe të pranoja misionin për të qenë përfaqësuesi i tyre në kuvendin që do të thirrej.”<sup>35</sup>

Nga vet deklaratimet e Ismail Qemalit kuptojmë se një pjesë e kreut intelektual shqiptar që ishin shkolluar dhe ngjitur në vertikalen administrative dhe politike osmane, nuk kishin në thelb dallime konceptuale dhe ideologjike, respektivisht Ismail Qemali nuk i vendosi kusht tjetër në rrafshin nacional Qamil Pashës në Paris, pos kërkesës shumë personale për tërheqje të dënimit të tij dhe kthimit të të drejtave civile.

Për ta pasur më të kristaltë ndjenjën e shqiptarit më qartë flet paragrafi përkatës i Ryan Gingeras:

“Një malësor shqiptar me banim në Ballkanin Perëndimor, nga këndvështrimi i një besnik të KOMITETIT PËR BASHKIM DHE PËRPARIM, nuk i interesonte se në çfarë alfabeti ishte shtypur gjuha e tij. Çështje të tilla të intelektit apo kulturës ishin përtej tij. Ajo që e shqetësonte më shumë ishte aftësia e tij për të mbajtur dhe përdorur pushkën si të donte. Me armë në dorë, ai mund të kryejë krime ose, më keq akoma, të rebelohet

<sup>35</sup> The Memoirs of Ismail Kemal Bey, Edited by SOMMERVILLE STORY, With a Preface by WILLIAM MORTON FULLERTON, LONDON CONSTABLE AND COMPANY LTD, 1920, f. 316.

ose t'i rezistojë shtetit nëse ai kërcënon autonominë e fshatit të tij në majë të malit. Ky ishte këndvështrimi i tij për politikën.”<sup>36</sup>

Gjithashtu Gingeras shkruan se një pjesë e parisë shqiptare ishin mjaft serioz në drejtim të avancimit të çështjes shqiptare. Më tej ai thotë: “Ashtu si shumë nga fqinjët e tyre sllavisht dhe greqishtfolës, një pjesë e konsiderueshme e liderëve shqiptarë urbanë dhe ruralë u deklaruan në favor të një autonomie më të madhe dhe reformave më liberale. Masat centralizuese, integruese, si ato të propozuara nga KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM në lidhje me gjuhën dhe arsimin, kërcënuan interesat e shumë shqiptarëve që dëshironin të njëjtat të drejta si ato që gëzonin historikisht mësuesit, intelektualët dhe veprimtarët grekë, serbë apo bullgarë. Unionizmi u shfaq edhe më i dyshimtë në sytë e komuniteteve të vendosura në rrethet malore në Ballkanin Perëndimor. Në rrethet e Janinës, Shkodrës dhe Kosovës, mbështetja për të drejtat kombëtare të shqiptarëve ishte e përzier me frikën e përgjithshme rurale ndaj rekrutimit, çarmatimit dhe vendosjes së taksave të reja (siç janë detyrimet tregtare). Disa personalitete të njohura kërkuan në mënyrë të pavarur garanci personale dhe komunale nga Greqia, Austria, Italia dhe Britania e Madhe me shpresën për të ruajtur gjurmët e autonomisë shqiptare. Ky ishte veçanërisht rasti i Ismail Qemalit, liberalit të vendosur që shkoi në mërgim pas dëbimit të tij nga parlamenti.”<sup>37</sup>

## 8. Zhgënjimi i popujve joturq

Megjithëse sulltan Abdylhamiti lëshoi pe para presionit të këshillit të turqve të rinj (xhonturqve nga Selaniku) dhe më 23 korrik 1908 shpalli kthimin në fuqi të Kushtetutës së 1876 dhe rithirrjen e parlamentit. Në fillim dha një shpresë të shqiptarët sikurse edhe të popujt tjerë të shtypur në Perandorinë Osmane, kjo nuk do të zgjasë shumë, meqë xhonturqit shumë shpejt do t'i harrojnë premtimet e dhëna gjatë procesit të revolucionit.<sup>38</sup>

<sup>36</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27. F.82.

<sup>37</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27. F.82.

<sup>38</sup> Sylë Ukshini, 1908: Shqiptarët kundër turqve të rinj, përmbyjsja nga agjentët serbë, Dielli, 16 korrik 2024,

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=893607172807806&id=100064755940971&set=a.483443540490840>, kërkuar më 23.11.2024.

Pas ardhjes në fuqi të xhonturqve, ata nuk i mbajtën premtimet që u kishin dhënë shqiptarëve (si dhe popujve të tjerë të shtypur). Kontradiktat shqiptaro-xhonturke çuan në kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912 dhe shthurjen e mëtejshme të vetë Perandorisë Osmane.

Durham: “Por para se të mbaronte viti, shqiptarët e kuptuan se nuk pritej sërish asnjë liri. Më kot fola me dy guvernatorët xhonturq. Greqia, Serbia, Bullgaria dhe Mali i Zi ishin të vendosur të mos i linin xhonturqit të kishin sukses, sepse kjo do të thoshte më asnjë mundësi për rrëmbim toke. Ata formuan Lidhjen Ballkanike për të rrëzuar qeverinë xhonturke përpara se ajo të kishte kohë për t’u konsoliduar. Në vitin 1910, shqiptarët e Kosovës u revoltuan, të nxitur nga serbët të cilët u prematuan ndihmë. Ata drejtoheshin nga gallati Isa Boletin. Një lajm i gëzuar erdhi në Shkodër. Isa kishte bërë marrëveshje me serbët.”<sup>39</sup>

“Kundërshtarët argumentuan se imponimi i turqishtes mbi komunitetet lokale nuk u shërbente rreptësisht nevojave administrative dhe politike të shtetit, por zbuloi një model të bashkërenduar të “turqizimit”. Ismail Qemali, i cili iku nga perandoria pas incidentit të 31 marsit, deklaroi se KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM kishte mashtruar shqiptarët dhe të tjerët me thirrje për unitet. Ajo që ata synonin nuk ishte një bashkim i “racave të ndryshme nën flamurin e kushtetutës osmane”, por krijimi i një shteti të krijuar për të “thithur kombësitë” dhe për t’i bërë ata “osmanë të dëgjueshëm dhe të zakonshëm” pa njohuri për origjinën e tyre kombëtare. Përbërja dominuese etnike e udhëheqjes së komitetit, të tjerë pozuan, dhanë tregues të vërtetë se si unionistët e perceptonin kulturën e vërtetë dominuese. Shumica e unionistëve kryesorë ishin turqishtfolës nga Ballkani Jugor, kryeqyteti ose rrethinat e tij. Në aspektin etnik, mbështetësit dhe kundërshtarët e KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM-së prireshin t’i shihnin të gjithë myslimanët që flisnin turqisht si “turq” pavarësisht nga prejardhja e tyre ose nga origjina e tyre.”<sup>40</sup>

Për zhgënjimin e madh të shqiptarëve Gingeras shkruan: “Nga frika se sundimi i KOMITETI PËR BASHKIM DHE PËRPARIM do të çonte në rënien e perandorisë, më shumë se disa nacionalistë shqiptarë shprehën kundërshtimin dhe militantizmin e tyre ndaj sundimit perandorak në terma të përmbledhur shoviniste. Çerçiz Topulli, një udhëheqës gueril nga Janina dhe dikur aleat i KOMITETIT PËR BASHKIM

<sup>39</sup> [http://www.albanianhistory.net/1941\\_Durham/index.html](http://www.albanianhistory.net/1941_Durham/index.html) Edith Durham

<sup>40</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27. F. 60

DHE PËRPARIM, u zotua se nuk kishte më nevojë “të derdhej më asnjë pikë gjaku për turqit” . Si një komb i nxjerrë nga “një nga degët më të përsosura të racave kaukaziane”, shqiptarët nuk kishin absolutisht asgjë të përbashkët me një perandori të rrënjësuar në popujt që vinin nga stepa aziatike.”<sup>41</sup>

Nga zgjedhjet e vjeshtës 1908, turqit muslimanë morën mezi shumicën në parlament me 147 ulëse, arabët 60, shqiptarët 27, grekët 26, armenët 14, sllavët 10 dhe izraelitët 4 ulëse.<sup>42</sup>

Përfaqësimi i grupeve të ndryshme etnike në parlamentin osman tregon se shqiptarët ishin menjëherë pas arabëve të përfaqësuar më tepër me ulëse, duke pasur parasysh se ata ishin shumë më tepër se shqiptarët sipas statistikave të kohës.

Interesat politike dhe territorial ndaj tokave shqiptare vazhdonin të ishin interesi i popujve të Ballkanit dhe Fuqive të Mëdha, ndërsa në këtë aspekt zhvillimet si rrjedhojë e lëvizjes xhonturke krijuan edhe paqartësi dhe dyshime në raport me fqinjët. Kështu Alfred Rapaport, u.d. agjenti civil austro-hungarez në Maqedoni, më 13 dhjetor 1908, do t’i shkruaj ministrit të jashtëm të A-H për gjendjen në këto hapësira. Në mes tjerash ai shkruan: “ Por një rrezik edhe më i madh është fakti se ripërtëritja e aksioneve çetnike bullgare dhe greke, për të cilat është folur shumë ditët e fundit, mund të ketë një ndikim të madh në elementin shqiptar. Tani për tani në Shqipëri, elementët kombëtarë shqiptarë indiferentë, partikularë, reaksionarë-fanatikë dhe të rinj shihen ende mjaft të kryqëzuar, por ideja se një provokim grek apo bullgar mund të përdoret nga të gjithë shqiptarët, përveç xhonturqve, është shumë aktuale. Të bashkuar në një fraksion mbrojtës kundër grekëve ose bullgarëve. Sado i bazuar të jetë dyshimi nëse një veprim i tillë do të çonte në një bashkim të përhershëm të shqiptarëve, ekziston rreziku që ai të shkaktojë vetëm trazira për keqardhje, duke e komplikuar me paraqitjen e vetë çështjes shqiptare dhe maqedonase.”<sup>43</sup>

<sup>41</sup> Ryan Gingeras, *The Greater War 1912-1923, Fall of the Sultanate The Great War and the End of the Ottoman Empire, 1908-1922*, 2016, f. 27. F. 60

<sup>42</sup> Jason Goodwin, *Lords of Horizons, A history of Ottoman Empire*, New York 1998, F.317.

<sup>43</sup> Telegrami nga Alfred Rapaport, U.D. Agjent Civil i Austro-Hngarisë në Maqedoni, dërguar Baronit Alois von Ehrenthal, Ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë, më 13 dhjetor 1908, Nr. 128. Архивски документи за историјата на Малдонскиот Народ, 1907- 1908, Том II, Скопје, 1981, f. 255.

## **Përfundime dhe konkluzione**

Në interes të ndriçimit dhe vlerësimit real të zhvillimeve politike dhe ushtarake të periudhës përkatëse në hapësirat shqiptare, Selanik dhe Stamboll, sigurisht që qasja hulumtuese dhe analitike duhet të aplikohet në disa dimensione, edhe atë:

Konstelacioni politik rajonal ne Ballkan.

Sferat e interesit nga fuqitë e mëdha.

Gjeopolitikat në rrafshin evropian.

Synimet e A-H për Ballkanin dhe prerja e rrugës së Rusisë.

Linjat hekurudhore Sanxhak-Mitrovicë-Shkup-Selanik, një strategji afatgjate austriake për relativizim të ndikimit serb në Evropën Juglindore.

Nxitja e shqiptarëve nga qarqet serbe dhe ata osmane (xhonturke), si strategji e mirë e organizuar për të penguar interesat A-H në territoret shqiptare.

Trajtimi i ngjarjeve në Ferizaj dhe Kuvendi i Ferizajit sipas rëndësisë dhe qasjes reale të një studimi.

Të ndriçohet qartë cili ishte niveli intelektual dhe politik i shqiptarëve në tërësi dhe krerëve të tyre në këtë fillim shekulli të 20-të.

Hapja e shkollave, shtypit, etj., pse u lejua në fillim dhe ndryshimi i qëndrimit pastaj.

Politika e decentralizimit dhe zvarritja e këtij procesi.

Te drejta kombëtare- shpresa e popujve të shtypur dhe zhgënjimi.

Të kristalizohet cilat ishin arsytet që u zhgënjyen shqiptarët menjëherë pas ardhjes në pushtet të xhonturqve.

Duke u mbështetur në dokumente arkivore dhe literature neutrale të qartësojmë pse shtetet sllave në Ballkan ishin kundër xhonturqve.

Historiografia shqiptare sot të korrespondojë me hulumtimet dhe dokumentimin e ngjarjeve në korrelacion me historiografinë bashkëkohore perëndimore.